



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:099105

Datë: 16.10.2024

Numri i dokumentit: 06302494

PAKR.nr.465/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Kadrije Goga Lubishtani, anëtar, me bashkëpunëtoren profesionale Njomza Svarça, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.B., nga fshati Kijevë, Komuna e Malishevës, për shkak të veprave penale, vrasje e rëndë, nga neni 173 par.1 nën par.1.5, 1.6 dhe 1.8 të KPK, dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 366 par.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesave, të Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Krimeve të Rënda, përfaqësuesit të autorizuar të palëve të dëmtuara, S.A. dhe O.B., av.Ismet Tofaj, dhe mbrojtësit së të akuzuarit B.B., av.Nuhi Krasniqi, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.2023:099105, të dt.18.06.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.03.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Me rastin e ankesave, të Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Krimeve të Rënda, përfaqësuesit të autorizuar të palëve të dëmtuara, S.A. dhe O.B., av.Ismet Tofaj, dhe mbrojtësit së të akuzuarit B.B., av.Nuhi Krasniqi, e sipas detyrës zyrtare, anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.2023:099105, të dt.18.06.2024, ashtu që çështja penale i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e vendosje.

Ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, përfaqësuesit të autorizuar të palëve të dëmtuara, S.A. dhe O.B., av.Ismet Tofaj, si dhe ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit B.B., av. Nuhi Krasniqi, tani për tani janë jo lëndore.

Me aktvendim të posaçëm të akuzuarit B.B., i vazhdohet paraburgimi, pasi që ende ekzistojnë kushtet ligjore.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.2023:099105, të dt.18.06.2024, është shpallur fajtor i akuzuari B.B., për veprat penale vrasje e rëndë, nga neni 173 par.1 nën par.1.8 të KPK, dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 366 par.1 të KPK, dhe i është shqiptuar,

-për veprën penale të përshkruar sikurse në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 20 (njëzetë) vite, e 6 (gjashtë) muaj,

-për veprën penale të përshkruar sikurse në pikën II, të dispozitivit aktgjykimit, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.

Në kuptim të nenit 76 të KPK, të akuzuarit B.B., i shqiptohet dënimi unik me burgim në kohëzgjatje prej 21 (njëzetënjë) viti, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej dt.28.04.2023, e tutje, por jo më shumë se sa dënimi i shqiptuar me burgim.

Të dëmtuarit, S.A., nga Anglia, Qyteti Birmingham - Mbretëria e Bashkuar, dhe O.B., nga Anglia, Qyteti Birmingham, për realizimin e kërkesës pasurore - juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.

Ndaj të akuzuarit janë konfiskuar, 1 (një) pistoletë gjysmë automatike të tipit “Cërvena Zastava”, model M88A e kalibrit 9x19mm, me nr. serik 19826, një karikator i zbrazët me kapacitet për tetë (8) fishekë të kalibrit 9x19mm i dizajnuar për pistoletë “Cërvena Zastava”, model M88A dhe gjashtë (6) fishekë të kalibrit 9x19mm si dhe 1 (një) pushkë e gjuetisë me dy tuta e tipit Huglu, model 104A, e kalibrit 12 bore me nr. serik 01S10810, një fishekë i kalibrit 7.65x17mm, një rrethatore prej lëkure e dizajnuar për mbajtje të fishekëve 12 bore, si objekte të kryerjes së veprës penale.

Është obliguar i akuzuari B.B., që të paguajë shpenzimet e procedurës penale, për ekspertizë psikiatrike shumë prej 300 €, si dhe për pjesëmarrje të ekspertit në seancë shumë prej 70 €, në emër të paushallit gjyqësor, shumë prej 200 €, si dhe shumë prej 50 € në emër të Fondit për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 30 ditëve, nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

Të akuzuarit i është vazhduar paraburgimi deri në plotfuqishmëri të aktgjykimit, por jo më shumë se koha e shqiptimit të dënimit me burgim.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë ushtruar:

- Prokuroria Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, për shkak të vendimit për dënimin, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, dhe aktgjykimi i

gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet, ashtu që të akuzuarit për veprat penale të kryera, ti shqiptohet një dënim më i rëndë.

-përfaqësuesi i autorizuar i palëve të dëmtuara, av. Ismet Tolaj, për shkak për të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.2023:099105, të dt.18.06.2024, të ndryshohet, ashtu që të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i ashpër me burgim, dhe

-mbrojtësi i të akuzuarit B.B., av.Nuhi Krasniqi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljet e ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe vendimit lidhur me sanksionin penal dhe shpenzimeve të procedurës penale, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e vendosje, ose aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.2023:099105, të dt.18.06.2024, të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i butë.

Prokuroria e Apelit, me shkresën PPA/I.nr.425/2024, të dt.07.08.2024, duke u sqaruar përkitazi me ankesat e ushtruara, nga ana e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, përfaqësuesit të autorizuar të palëve të dëmtuara, av.Ismet Tofaj, dhe mbrojtësit së të akuzuarit B.B., av. Nuhi Krasniqi, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.2023:099105, të dt.18.06.2024, si shkresave të tjera të lëndës, ka propozuar që ankesa e ushtruar, nga ana e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, të aprovohet si e bazuar, ashtu që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit B.B., për veprat penale të për të cilat është shpallur fajtor, ti shqiptohet dënim më i ashpër.

Sa i përket ankesës së përfaqësuesit të autorizuar të palëve të dëmtuara, av.Ismet Tofaj, e njëjta të aprovohet pjesërisht si e bazuar, lidhur me vendimin për dënimin, dhe të akuzuarit për shkak të veprës penale të vrasjes së rëndë, nga neni 173 par.1 nën par.1.8 të KPK, ti shqiptohet dënim më i ashpër, kurse sa i përket veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 366 par.1 të KPK, ankesa të hudhet si e pa lejuar.

Ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit B.B., av.Nuhi Krasniqi, të refuzohet si e pa bazuar për shkak të gjitha bazave ankimore.

Në kuptim të nenit 390 të KPPK, kolegji i kësaj gjykate ka caktuar seancën e kolegjit për dt.03.10.2024, dhe në mënyrë të rregullt i ka njoftuar të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Në seancë të kolegjit kanë prezantuar, përfaqësuesi i palëve të dëmtuara, av. Ismet Tofaj, i akuzuari B.B., dhe mbrojtësja e tij, av. Mejreme Ismaili, e cila në seancë të kolegjit ka deponuar

autorizimin për të përfaqësuar të akuzuarin B.B., në seancë të kolegjit dhe për veprime të mëtejme procedurale.

Nuk ka prezantuar Prokurori i Apelit, si dhe palët e dëmtuara, edhe pse janë njoftuar me rregull.

Përfaqësuesi i palëve të dëmtuara, av. Ismet Tofaj, ka deklaruar se mbetet pranë ankesës së ushtruar, dhe ka propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i ashpër.

Mbrojtësja e të akuzuarit B.B., av. Mejreme Ismaili, deklaroi se mbetet në tërësi pranë ankesës së ushtruar, nga ana e kolegjit av. Nuhi Krasniqi dhe në këtë çështje penale jam e mendimit se ka pasur shkelje të shumta esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat kanë ndikuar edhe në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe shkeljeve të ligjit penal. Në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë, nuk e ka vërtetuar motivin e kryerjes së veprës penale, e po ashtu nuk ka ndërmarrë hapa që të bëjë ekspertizë lidhur me gjendje psikike të akuzuarit, duke pasur parasysh që i njëjti vuan nga çrregullimet mendore, sepse edhe familjarët e tij, kanë po të njëjtat çrregullime.

I akuzuari B.B., deklaroi se pajtohet në tërësi me deklaratimet e mbrojtjes.

Kolegji i kësaj gjykate në kuptim të nenit 394 të KPPK, ka vlerësuar ankesat e ushtruara, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se:

Aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të tjera të cilat kushtëzojnë anulimin e tij.

Përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, ankesë ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit B.B., av. Nuhi Krasniqi, duke potencuar se në këtë çështje penale, gjykata e shkallës së parë, nuk është përkujdesur që të vërtetoj se në këtë çështje penale për tu proceduar më tutje, a kemi të bëjmë me shkeljet e dispozitave të procedurës penale, apo jo, kurse sipas mendimit tonë, këto shkelje konsistojnë në kuptim të nenit 384 par.1 nën par.1.3 lidhur me par.2, nën par.2.2, 2.4 dhe 2.5 të KPPK. Shqyrtimi gjyqësor është mbajtur sipas ritmit të përcaktuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, mirëpo mbrojtja ka paraqitur propozimin e njëra ndër to ka qenë që të dëgjohet dëshmitari S.B., mirëpo gjykata e ka refuzuar, duke dhënë arsye se i njëjti nuk ka qenë dëshmitar okular (pamor). Me refuzimin e këtij dëshmitari, nuk ka hapur mundësinë e vetëtimtit të motivit të kryerjes së veprës penale, ngase kualifikimi juridik sipas hyrjes së dispozitivit të aktgjykimit, sikurse theksohet se i akuzuari është shpallur fajtor për shkak të veprës penale të vrasje së rëndë nga neni 173 part.1 nën par.1.5, 1.6, dhe 1.8 të KPK, nuk mund të qëndroj, sepse në hyrje paraqiten dilema, se cili është veprimi kualifikues nga kjo vepër penale,

ngase nuk i është dhënë lidhur të gjitha pikave të nenit përkatës, duke pasur parasysh se 173 par.1 pika 1.5, shprehimisht thekson “privon nga jeta personin tjetër dhe me atë rast me dashje e vënë në rrezik jetën e një ose më shumë personave tjerë”, po të njëjtin nen par.1.6 të KPK, “privon nga jeta personin tjetër me qëllim të fitimit të dobisë pasurore”, në vijimësi pika 1.8 të KPK, “privon nga jeta personin tjetër nga hakmarrja e paskrupullt, apo nga motivet e tjera të ulëta, përfshirë hakmarrjen apo dhënien e dëshmisë, ose sigurimin në ndonjë mënyrë tjetër, të informatave për policinë, apo në procedurë penale”, që nënkupton që në këtë çështje penale nga gjykata e shkallës së parë, nuk është vërtetuar elementi karakterizues i veprës penale të vrasjes së rëndë, por kanë dalë shumë tipizime të veprës penale.

Që të gjitha këto çështje të ngritura nga ana e mbrojtësit së të akuzuarit, nuk janë përfshirë në bazën ankimore për të cilën edhe është ushtruar ankesë, mirëpo, kolegji i kësaj gjykate pasi që ka vlerësuar që të gjitha ankesat e ushtruara, dhe sipas detyrës zyrtare ka ardhur në përfundim se çështja penale e cila gjykohet, e sidomos të nxjerrja e aktgjykimit apo aktvendimit, gjithmonë duhet të jenë në harmoni me dispozitat ligjore nga neni 384 par.2 pika 2.7 lidhur me nenin 369 të KPPK, ngase aktgjykimi i nxjerrë, duhet të jetë i kuptueshëm, i qartë dhe në harmoni me vetveten, si dhe pjesë tjera të aktgjykimit, për tu dhënë arsye lidhur me faktet vendimtare të cilat e karakterizojnë veprën penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit.

Nga kjo rezulton se dispozitivi i aktgjykimit sa i përket të akuzuarit B.B., i cili është shpallur fajtor sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.2023:099105, i dt.18.06.2024, në hyrje thekson veprën penale të vrasjes së rëndë, nga neni 173 par.1 nën par.1.5, 1.6 dhe 1.8 të KPK, që nënkupton se shkaktohet mbi ngarkim në dispozitën ligjore, sepse nuk mund të ekzistojnë që të tri karakteristikat e veprës penale të vrasjes së rëndë, sikurse është privon nga jeta personin tjetër, dhe me atë raste me dashje vënë në rrezik jetën e një apo më shumë personave të tjerë, që nuk është vërtetuar elementi tipizues, i kësaj vepre penale, se privon nga jeta përsosnin tjetër me qëllim të fitimit të dobisë pasurore, e cila nuk është vërtetuar në masë të duhur, për të vërtetuar cili është përfitimi pasuror, nga kryerja e kësaj vepre penale, si dhe privon nga jeta personin tjetër nga hakmarrja e paskrupullt, duke mos e vërtetuar nocionin e paskrupullsisë për tu lidhur me hakmarrjen. Sipas konceptit të përgjithshëm nga kjo rezulton se gjykata e shkallës së parë, flet vetëm për hakmarrjen e paskrupullt, duke mos dhënë arsye për vrasjen e paskrupullt, sepse një vrasje mund të jetë e paskrupullt dhe fare të mos jetë e kryer nga hakmarrja, por falja vjen nga interesi. Duke vlerësuar këtë nocion të vrasjes nga hakmarrja e paskrupullt dhe duke u nisur nga termi paskrupull, atëherë rezulton se kjo çështje penale nuk është vërtetuar në masë të duhur, duke pasur parasysh që hakmarrja apo vepra penale e kryer nga hakmarrja e paskrupullt, kryhen nga motive të tjera të ulëta, në këtë drejtim nuk është vërtetuar në masë të duhur për të dëgjuar dëshmitarët edhe lidhur me këtë vepër penale të kryer, prandaj në këtë drejtim jemi të mendimit dhe të bindur se gjykata e shkallës së parë, nuk ka arritur ti vërtetoj këto elemente që rezultojnë edhe mos vërtetimin e motivit të kryerjes së veprës penale.

Kur flitet për motivin e kryerjes së veprës penale, shumë me rëndësi të kihet parasysh që i njëjti gjithnjë duhet të jetë i vërtetuar me ekzistimin e një vepre penale, e sidomos në rastin konkret kur kemi të bëjmë me veprën penale të vrasjes së rëndë, e cila ka shumë karakteristika të parapara në dispozitën ligjore nga neni 173 të KPK, duke filluar nga neni 1, me pika nga 1.1 deri në 1.13 të KPK, ashtu që këto çështje kanë ngelur të pa shqyrtuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë.

Gjithashtu nga shkresat e lëndës rezulton se sa i përket të akuzuarit B.B., i cili është ngarkuar me veprat penale, të cilat iu janë vu në barrë, në përshkrim të pikës I të dispozitivit të aktgjykimit, është shpallur fajtor për veprën penale vrasje e rëndë, nga neni 173 par.1 nën par.1.8 të KPK, që paraqet menjëherë largim nga përshkrimi i bërë në hyrje të aktgjykimit, pra në pjesën hyrëse, andaj edhe në këtë drejtim kolegji i kësaj gjykate është i bindur se është bërë shkëputje në mes të pjesëve përbërëse të aktgjykimit, kurse detyrimisht është imperativ i gjykatës që çdo pjesë e aktgjykimit të ketë lidhje të pa shkëputur, dhe gjithnjë në pjesën hyrëse të përshkruara sikurse në këtë aktgjykim, e njëjta të ketë harmoni me dispozitivin.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë çështje penale nuk është bërë rekonstruimi i vendit të ngjarjes, për të vërtetuar se cilat kanë qenë veprimet e ndërmarra nga ana e të akuzuarit për të kryer veprën penale, që është obligim që të vërtetohen të gjitha pjesët e aktgjykimit, pastaj propozimet e ngritura nga ana e palëve të vendoset që të janë prezent në gjykim, e po ashtu edhe të zbatohen dispozitat ligjore, duke u respektuar të drejtat e të gjitha palëve në procedurë, dhe të krijohen kushte që gjithnjë çështja e sjellë për gjykim të gjykohet tërësisht.

I akuzuari B.B., rezulton se është shpallur fajtor, për veprat penale të përshkruara sikurse në dispozitiv të aktgjykimit, mirëpo duke pasur parasysh edhe çështje të tjera të deponuara nga ana e palëve në procedurë, rezulton se i njëjti rrjedh nga një familje që kanë çrregullime mendore, të cilët kanë deponuar edhe ekspertiza të cilët janë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës, për të afërmit e të akuzuarit, motrën V.D., vëllain e të akuzuarit Z.B. dhe nënën e të akuzuarit S.B., kolegji i kësaj gjykate është i mendimit që për të vërtetuar gjendjen mendore të akuzuarit, të bëhet ekspertizë psikiatrike nga ana e ekspertëve, duke pasur parasysh edhe dokumentacionin shtesë për të vërtetuar më hollësisht motivin e vrasjes së veprës penale dhe për të ardhur në përfundim se vepra është kryer nga xhelozia, sa i përket raporteve me bashkëshorten e tij, çështje të cilat kanë mbetur pa u sqaruar.

Duke vlerësuar se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, përfshihet me shkeljet esenciale sikurse u theksuan më lartë, sikurse janë ato që pjesa hyrëse nuk përputhet me dispozitivin e aktgjykimit, përkitazi me veprën penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit, sepse në pjesën hyrëse kemi tri pika karakteristike të veprës penale të vrasjes së rëndë, kurse në dispozitiv vetëm një pikë karakteristike të vrasjes së rëndë, gjykata e shkallës së parë duhet të përkujdeset që të na jep pasqyrimin e drejtë se për çfarë vepre penale është akuzuar i akuzuari, të vërtetoj të gjitha elementet karakteristike të veprës penale të cilat përshkruhen në dispozitiv të

aktgjykimit, duke dhënë arse të mjaftueshme lidhur me ekzistimin e veprës penale, që në këtë çështje penale, të bëjë ekspertizën përkatëse për të vërtetuar gjendjen psikike të akuzuarit, në momentin e kryerjes së veprës penale, për të vërtetuar motivin e kryerjes së veprës penale, duke pasur parasysh që vepra penale e vrasjes së rëndë, nga neni 173 par.1 pika 1.8 të KPK, ka disa trajta të kryerjes së të njëjtës, andaj është obligim ligjor i gjykatës që të vërtetoj se vepra penale a është kryer nga hakmarrja e paskrupullt, apo nga motive të tjera të ulëta, përfshirë hakmarrjen për dhënien e dëshmisë, ose sigurimin në ndonjë mënyrë tjetër të informatave, për policinë apo në procedurë penale.

Nga kjo rezulton se gjykata e shkallës së parë, është mirë që të bëjë vlerësimin e të gjitha deklaratave si dhe të bëjë precizimin e të gjitha çështjeve, që kërkohen nga dispozitat ligjore për të vërtetuar ekzistimin e veprës penale, e po ashtu të bëjë edhe ekspertizë psikiatrike për të akuzuarin, për të vërtetuar gjendjen psikike të të njëjtëve, sepse nga dokumentacioni – ekspertizat e ofruara nga ana e mbrojtjes së të akuzuarit, përkitazi me nënën e të akuzuarit S.B., vëllain Z.B., si dhe motrën e të akuzuarit V.D., kemi dokumentacion se të njëjtit kanë çrregullime mendore, dhe do të ishte mirë që ti epet mendimi lidhur me gjendjen shëndetësore të akuzuarit, për të vërtetuar kryerjen e veprës penale.

Në këtë çështje penale duhet bërë edhe rekonstruktimi i vendit të ngjarjes, sikurse kërkojnë dispozitat ligjore, e po ashtu të dëgjohen edhe dëshmitarët edhe njëherë secili veç e veç, S.A., O.B., B.H. dhe D.D., si dhe dëshmitarët Z.B., A.B. dhe B.Th., e sipas rrjedhës së procedurës, të nxjerrën edhe prova të tjera të cilat janë me rëndësi për të vërtetuar veprën penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit.

Kolegji ka vlerësuar se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është përfshirë me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat kanë ndikuar edhe në vërtetimin e gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike, e që të dy këto shkelje kanë ndikuar në shkeljen e ligjit penal, sepse gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur që të vërtetoj elementet e veprës penale e cila i vihet në barrë, të akuzuarit, për të arsyetuar ekzistimin apo mos ekzistimin e veprës penale të përshkruar sikurse në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, gjithnjë duke pasur parasysh se nga elementet karakteristike dhe përshkrimi faktik i veprës penale, ekzistimi i të dëmtuarit, si dhe normalisht kryesi i veprës penale, atëherë vërtetohet edhe vepra penale për të cilën i akuzuari shpallet fajtor.

Të gjitha këto elemente pasi që të procedohen dhe vlerësohen nga ana e gjykatës së shkallës së parë, atëherë kolegji është i bindur se në këtë çështje penale duhet të nxirret vendim sa më i drejtë, dhe me të cilin do të arrihet që çështja penale të gjykohet si tersi dhe mos të ketë disproporcion në mes të çështjes penale, duke filluar nga përpilimi i aktgjykimit deri te vlerësimi dhe vërtetimi i të gjitha deklaratave, përkatësisht provave personale dhe materiale, nga shkresat e lëndës.

Pasi që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat janë vlerësuar sipas detyrës zyrtare, ankesat e Prokurorisë Themelore, përfaqësuesit të autorizuar të palëve të dëmtuara, si dhe ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit, nuk janë shqyrtuar, pasi që çështja penale është anuluar dhe i është kthyer gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e vendosje.

Ndaj të akuzuarit B.B., është vendosur që të vazhdoj paraburgimin në kuptim të nenit 402 par.5 të KPPK.

Vendimi lidhur me konfiskimin e sendeve që kanë qenë të përfshira në kryerjen e veprës penale është bazuar në kuptim të nenit 366 par.3 të KPPK.

Po ashtu të gjitha vendimet e tjera të marra në këtë çështje penale kanë mbështetjen e duhur ligjore.

Nga arsyet e cekura më lartë, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, në kuptim të nenit 402 të KPPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.465/2024, të datës 03.10.2024

Procesmbajtësja,
Njomza Svarça

Anëtarët e kolegjit,
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit,
Xhevdet Abazi

Kadrije Goga Lubishtani